



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 2650 Prot.

Tiranë, më 10.10.2024

UDHËZIM

Nr. 5 datë 10.10.2024

**“PËR  
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NË  
PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR TË  
CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, RAUNDI III, NË UNIVERSITETIN E  
MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2024-2025”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë...”, Udhëzimit të MAS nr. 12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit...”, si dhe Urdhrit të Përbashkët të RASH dhe QSHA nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit...” i ndryshuar, lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit në kuadër të plotësimit të kuotave të mbetura bosh në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, Raundi III,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania dhe që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, aplikojnë pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore (fakultetit) përkatëse, në datat **11 dhe 14 tetor 2024**, nga ora **8:00** deri në **14:00**.
2. Kandidatët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Kërkesën me shkrim për aplikim në atë program studimi (sipas modelit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
  - b) Kopje të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën përkatëse të notave (për të gjitha vitet e shkollës së mesme);
  - c) Kopje të dokumentit të identifikimit;
3. Njësitë kryesore brenda datës **14 tetor 2024**, përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve. Publikimi i listave të kandidatëve sipas renditjes bëhet me datë **15 tetor 2024** në faqen zyrtare të njësisë kryesore përkatëse dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

4. Me datë **16 dhe 17 tetor 2024**, bëhet regjistrimi i kandidatëve sipas renditjes së shpallur në pikën 3, pranë njësive kryesore në përputhje me kuotat e mbetura bosh, si më poshtë:

**Data 16 tetor 2024**

*Faza I – ora 9.<sup>00</sup>-11.<sup>00</sup>*  
*Faza II – ora 11.<sup>01</sup>-13.<sup>00</sup>*  
*Faza III- ora 13.<sup>01</sup>-15.<sup>00</sup>*  
*Faza IV- ora 15.<sup>01</sup>-17.<sup>00</sup>*

**Data 17 tetor 2024**

*Faza I – ora 9.<sup>00</sup>-11.<sup>00</sup>*  
*Faza II – ora 11.<sup>01</sup>-13.<sup>00</sup>*  
*Faza III- ora 13.<sup>01</sup>-15.<sup>00</sup>*  
*Faza IV- ora 15.<sup>01</sup>-17.<sup>00</sup>*

5. Kandidati fitues ka të drejtë të **regjistrohet brenda minifazës 2 orëshe**, në të kundërt vendi fitues i kalon kandidatëve në pritje sipas listës së renditur.
6. Njësitë kryesore përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve të regjistruar brenda datës **18 tetor 2024**.
7. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen njësitë kryesore të UMT-së dhe sekretariatë mësimore.



**Shtojca nr. 1**

**FORMULAR KËRKESË**

Unë e/i nënshkruara/i, \_\_\_\_\_, ID e maturës \_\_\_\_\_, aplikant pjesë e portalit U-Albania, paraqes kërkesën time për të vijuar konkurrimin në programin e studimit \_\_\_\_\_.

- Deklaroj se nuk jam regjistruar në asnjë program tjetër studimi.
- Jam informuar nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë kryesore (fakulteti) dhe universitetit, për Udhëzimin Nr.5, datë 10.10.2024 “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve ...” të Rektorit të UMT-së, lidhur me publikimin e renditjes dhe fazat e regjistrimit të kandidatëve.

---

Emër

Atësi

Mbiemër

Nr. telefoni: